



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 63, Datë 01.03.2021

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR, ALBGAZ SH.A.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 91, pika 2 dhe nenit 92, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 32/1 prot., datë 26.02.2021 të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, ALBGAZ sh.a.”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 263, datë 28.12.2020, ka vendosur:
 - *Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për gazin natyror, “ALBGAZ” sh.a.;*
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje janë lajmëruar palët e interesit për shprehjen e opinionëve të tyre në lidhje me fillimin e kësaj procedure, si dhe ALBGAZ sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 53 prot., datë 13.01.2021 ku i është kërkuar që të marrë në konsideratë konstatimet e vendimit të sipërcituar dhe të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës me qëllim përfundimin e procedurës.
- Pas korrespondencës së zhvilluar me ALBGAZ sh.a., rezulton se nuk është përditësuar ende Programi i përputhshmërisë së ALBGAZ sh.a., me konstatimet e vendimit të bordit të ERE-s nr. 263/2020.
- Në nenin 91, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se “Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë”.
- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

1. Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91, të këtij Kodi.
 2. Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.
- Në përmbushje të këtij afati, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria “ALBGAZ” sh.a., nuk është sqaruar ende plotësisht për përditësimin e konstatimeve të vendimit të bordit të ERE-s nr. 263/2020, në Programin e përputhshmërisë, e mund të jetë e nevojshme dhe organizimi i një takimi virtual për këtë qëllim, duke pasur parasysh faktin që shoqëria është në fazën e përkthimit të programit, i cili duhet dërguar dhe për opinion tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, si dhe duke pasur parasysh dhe rrethanat kufizuese të krijuara për shkak të pandemisë COVID-19, vlerësohet të zgjatet afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 30 ditë pune.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “ALBGAZ” sh.a..
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI